



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Data 14 / 10 / 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT :

“Rikualifikim i rrugëve Ligatë-Lumas-Dokollarë-Pëllumbas”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi 45233120-6 (punime ndërtimi për rrugë).

VLERA E FONDIT LIMIT :

44 553 956 (*dyzetë e katër milion e pesëqind e pesëtdhjetë e tre mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë*) lekë pa tvsh, të vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Kuçovë, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Kuçovë Nr 47 datë 20.12.2023 me objekt “Për Miratimin e Buxhetit Afatmesëm” 2024 - 2026, si dhe të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë :

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 dhe 2024 duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.

4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2023 dhe 2024 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”, ku detyrimi i ofertuesve është të paraqesin likuidimin e taksave për të paktën këstin e tretë të vitit fiskal.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 80% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 80% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) **vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:
 - a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
 - b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
 - c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse,*
 - d) *Akt Kolaudimi*
 - e) *Faturat tatimore*
- Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen:
 - a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
 - b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
 - c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse.*
 - d) *Akti i Kolaudimit*
 - e) *Faturat tatimore,*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë jo më e vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël **180%** të vlerës së fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

1. NP – 1 A Punime gjurmimi në tokë
2. NP– 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3. NP – 12 A Punime te Inxhinierise se Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

1. NS - 18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P. 1 A (Punime gjurmimi në tokë)

Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Duke analizuar preventivin e punimeve, liçensa e mësipërme përkon me punimet si 3.89/a Gjurmim dhe me eskavator me goma 0.25 m³ në kanale gjerësi deri në 2 m tokë zak, kategoria III me shk në mjet në sasinë 410 m³.

NP- 4 B (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të

veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Duke parë dhe vetë objektin e prokurimit i cili është “Rikualifikim i rrugëve Ligatë-Lumas-Dokollarë-Pëllumbas” kjo kategori ndërtimi përkon dhe është në përputhje dhe vëllim të plotë me investimin që do të kryhet (e cila përshtatet me çdo zë të preventivit të punimeve). Bazuar mbi objektin e prokurimit, qëllimi kryesor i autoritetit kontraktor është shtrimi i rrugëve në Njësinë Administrative Lumas, duke i siguruar banorëve të zonës kushte më të mira jetesë (një rrugë e cila nuk ka patur asnjëherë investim).

Bazuar dhe nga preventive i punimeve ku përfshin punë të tilla si psh, 3.207/1 shtresë çakëlli mbeturina kave $t=10\text{cm}$ në sasinë 14198 m^2 , 3.212/b shtresë stabilizanti 10cm në sasinë 14198 m^2 , 3.233/4 shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7cm me makineri në sasinë 12620 m^2 etj, të cilat janë në përputhje me liçensën e mësipërme të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të VKM-së nr. 42, është vënë dhe kategoria B për të gjitha kategoritë e kërkuar sipas nivelit nga 21 deri në 50 milion lekë.

Duke qenë se vetëm zëri 3.233/4 shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7cm me makineri në sasinë 12620 m^2 , kalon vlerën mbi 21 milion, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa e licenses së mësipërme në kategorinë B është në përputhje dhe vëllim të plotë

NP – 12 A Punime te Inxhinierise se Mjedisit

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik.

Referuar zërave të preventivit kemi të bëjmë me punime gjelbërimi si prerje bimë të vola, ndërtimi i terreneve të jashtme, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin perreth. Gjatë zbatimit të projektit në realizimin e plotë të kontratës, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmerie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale. Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS - 18 A (Punime Topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh)

Referuar natyrës së punimeve të mësipërme për këto të fundit, shfaqet e nevojshme disponueshmëria e kategorive të licencës për zbatim NS 18 - A, si punime të cilat përfshihen në grupin e punimeve parashikuar në lidhjen nr.3 të Vendimit 17 nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Ku kjo kategori kër kohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gjermim kanali etj sepse ai merret me rilevimit e tokës, kuarot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet

Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të VKM-së nr. 42, është vënë dhe kategoria A për të gjitha kategoritë e kërkuar sipas nivelit nga 0 deri në 20 milion lekë .

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

1) Inxhinier Ndërtimi (profili Gjeoteknik)	1 (një)
2) Inxhinier Topograf	1 (një)
3) Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
4) Inxhinier Elektrik	1 (një)
5) Inxhinier Mjedisi	1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit.

Në lidhje me inxhinierin profili gjeoteknik, lejohet të plotësohet nga ofertuesit edhe në listëpagesat e tyre për 3 muajt e fundit, jo domosdoshmërit si drejtues teknik i shoqërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :

Për secilin pjestar te stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontrate pune e vlefshme, diplomë, (Drejtuesit teknik të jenë të siguar sipas legjislacionit në fuqi)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një Inxhinier ndërtimi profile infrastrukturë transporti, Topograf dhe inxhinier hidroteknik parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

- **Inxhinier Gjeoteknik**

Inxhinieri Gjeoteknik është i nevojshëm pasi ai do të verifikojë në terren kapacitetet mbajtëse të tokës dhe lidhjen e saj me tipin e zgjedhur të themelit dhe implementimin e mure buto betoni C12/15 si dhe shtruktura monolite betoni C20/25, përta i përket ndërtimit të murit mbajtës të rrugës. Inxhinieri Gjeoteknik ka rëndësi të vecantë sidomos në rastin konkret me fushën e përcaktimit të karierave të materialeve që do të përdoren për nënshtresat, për shtresë stabilizuese si dhe për materialet që do të përdoren për e themelet e strukturës së betonit për murin mbajtës dhe për materialet e betoneve të tjera. Projekti zbatohet mbi formacione gjeologjike që kërkojnë ekspertizën e inxhinierit të sipërcituar. Bazuar në hartën e re sizmike ku i gjithë territori i Shqipërisë konsiderohet me sizmicitet të lartë, kujdesi dhe nevoja për staf të kualifikuar aq më tepër për stafin tekniko – inxhinierik si Inxhinieri Gjeoteknik është e evidente. Pasi bëhet inspektimi në vend si dhe provat laboratorike, i propozohen mbikqyrësit të punimeve Mix – Design e Betoneve. Një rëndësi të madhe do të ketë prezenca e Ing. Gjeoteknik gjatë ndërtimit të shtresave të terreneve dhe themeleve të mureve mbajtës për shkak se terreni ku zbatohet kontrata është terren jo i qendrueshëm dhe kodrinor.

Akoma më tej njësi e prokurimit e ka lënë të hapur plotësimin e kriterit të sipërcituar, duke lejuar disponueshmërinë e tij edhe në listëpagesat e shoqërisë, jo domosdoshmërisht si drejtues teknik i shoqërisë

- **Inxhinier Topograf** **1 (një)**

Inxhinier topograf kërkohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gërmim kanali etj sepse ai merret me rilevimit e tokës, kuatot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet etj. Prania e topografit është e domosdoshme në terren për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke i dhënë garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses.

- **Inxhinier Hidroteknik** **1 (një)**

Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierit Hidroteknik, njësi e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor, në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një Inxhinier Hidroteknik, dhe referuar

volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, parë kjo në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e punimeve, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

Duke analizuar preventivin e punimeve, inxhinieri i mësipërm përkon me punimet në zërat përkatës si :

1.131/p Tuba betoni Ø 400 mm në sasinë 38 m

3.652 Furnizim vendosje tuba plastmasi Ø 200 në sasinë 15 m

3.654/1 Furnizim vendosje tuba plastmasi Ø 80 në sasinë 400 m

➤ **Inxhinier Elektrik**

1 (një)

Është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike, pasi referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen instalime elektrike, të cilat kërkojnë detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri elektrik gjatë periudhës të zbatimit të punimeve.

Duke analizuar preventivin e punimeve, inxhinieri i mësipërm përkon me punimet në zërat përkatës si :

3.169 F V Shtylla metalike për ndriçim, H=7m, d= 160mm në sasinë 20 copë

3.168 F V Shtylla metalike KRH – MSI 1500/1500/10

3.175 F V ndriçues Smart VP CL 1 CR M-S 250w GG FAE 44004, me llampë 250w 230v

Si dhe instalime për ndriçim

2.496 F.V Elektroda tokëzimi, profil zingato e bakërizuar, L=1.5m

Dhe 4.131/3.5 F.V në tokë kablllo Cu fuqie ÷ 1000V, me izolim gome e mbulesë plastmasi, të armuar, 4 x 10 mm²

➤ **Inxhinier Mjedisi**

1 (një)

Është përgjegjës për zbatimin e zërave të preventivit për punime gjermimi, ndërtimi i terreneve të jashtme, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjatë zbatimit të projektit në realizimin e plotë të kontratës, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina

e inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale.

Bazuar edhe në specifikimet teknike të hartuar, është parashikuar dhe mbrojtja e ambientit.

Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të ndër marrë të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjent lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë dhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mosplotësimi i kësaj klauzole në bazë të evidentimit nga mbikqyrësi i punimeve mund të çojë në ndërprerjen e kontratës.

Në seksionin “Pastrimi përfundimtar i zonës”.

Në përfundim të punës sa herë që është e aplikueshme sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjithë impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. Pagesa përfundimtare e kontratës do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi jepet miratimi nga mbikëqyrësi i punimeve.

2.3.4 Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë **punonjës të specializuar / të kualifikuar**, për të paktën 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës si staf teknik punonjësit si më poshtë :

NR	EMËRTIMI	PUNONJËS
1	Elektriçist	2 (dy)
2	Eskavatorist	2 (dy)
3	Automakinist	1 (një)
4	Buldozerist	1 (një)
5	Shofer	2 (dy)
6	Hidraulik	2 (dy)
7	Mekanik	1 (një)
8	Teknik ndërtimi	1 (një)
9	Teknik Gjeodet/Topograf	1 (një)
10	Teknik Hidroteknik	1 (një)

11	Specialist për punime në rrugë	3 (tre)
12	Karpentier	3 (tre)
13	Hekurkthyes	2 (dy)
14	Punëtor krahu	7 (shtatë)
15	Specialist Ndertimi	2 (dy)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8 .

Përpara lidhjes së kontratës për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë :

Dëshmi kualifikimit të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, **ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)**, kontrate pune e vlefshme.

Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.

Të paraqiten listëpagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm të figurojnë .

Për teknikun e ndërtimit, teknikun hidroteknik, teknikun gjeodet/topograf, duhet të paraqitet dhe deftesë e shkollës së mesme.

Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR.

Në rastin kur mjetet e kërkuar më poshtë në pikën **2.3.8** janë me qera nuk është kusht që shoferët të jenë në listëpagesën e shoqërisë, ata do të lejohen të plotësohen nga ofertuesit **edhe nëpërmjet kontraktimit për këtë objekt prokurimi.**

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime / kualifikime).

Argumentimi në lidhje me pikën 2.3.4. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit sqaron se të gjithë punonjësit e kërkuar si më sipër me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik apo certifikata ekuivalente të tyre, përkojnë me punimet sipas preventivit të publikuar në SPE, dhe konkretisht :

Për elektrikist 2 (dy) punonjës

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, ku parashikohet :

3.169 F V Shtylla metalike për ndriçim, H=7m, d= 160mm në sasinë 20 copë

3.168 F V Shtylla metalike KRH – MSI 1500/1500/10

3.175 F V ndriçues Smart VP CL 1 CR M-S 250w GG FAE 44004, me llampë 250w 230v

Si dhe instalime për ndriçim

2.496 F.V Elektroda tokëzimi, profil zingato e bakërizuar, L=1.5m

Dhe 4.131/3.5 F.V në tokë kablo Cu fuqie ÷ 1000V, me izolim gome e mbulesë plastmasi, të armuar, 4 x 10 mm², garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses nëpërmjet disponimit të elektrikistit nga ana e operatorëve ekonomik ofertuesve.

Për eskavatorist 2 (dy) punonjës, automakinist 1 (një) punonjës, buldozerist 1 (një) si dhe dy shofer,

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, ku parashikohet shtrimi i shtresës së asfaltbetonit me makineri autobitumatriçe dhe asfaltoshtruese në sasinë 12620 m², ku parashikohet shtrimi i rrugës me shtresë çakëll në sasinë 14198 m² dhe shtresë stabilizanti në sasinë 14198 m², garanton autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të disponojnë drejtues për makineri të rënda për zbatimin e kontratës me sukses

dhe në kohë, për sa kohë disponueshmëria e tyre lidhet drejtëpërdrejtë me manovrimin e mjeteve si Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton 2 (dy copë), dhe minimumi 10 ton 2 (dy) copë për transportimin e mallrave të mësipërm pranë kantierit të ndërtimit, Kamioncine me kapacitet mbajtës deri në 1.5 t 2 (dy copë), Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton 2 (dy copë), Kamion me vinc 1 (një) copë, Rul ngjeshës me vibrim 1 (një) copë, Fadromë me goma 1 (një) copë, Asfaltoshtruese 1 (një) copë, Autobitumatriçe 1 (një) copë, RTV - Transportier për mjete të renda, Rrul asfalti hekuri 1 (një) copë, Rrul ngjeshës me gomë 1 (një) copë për ngjeshjen sistemimin e çakullit dhe stabilizantit.

Akoma më tej, kriteri i mësipërm është lënë i hapur për tu plotësuar nga ofertuesit për sa kohë disponimi i tyre lejohet të përmbushet edhe nëpërmjet nënkontraktimit në rastet kur mjetet e kërkuar më poshtë sipas pikës 2.3.8 janë me qera.

Referuar numrit të madhë të mjeteve, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor është në përputhje me objektin e prokurimit.

Për Hidraulik 2 (dy) punonjës, Teknik Hidroteknik 1 (një)

Duke analizuar preventivin e punimeve, punonjësit e mësipërm përkon me punimet nën udhëheqjen e inxhinierit hidroteknik në zërat përkatës si :

1.131/p Tuba betoni Ø 400 mm në sasinë 38 m

3.652 Furnizim vendosje tuba plastmasi Ø 200 në sasinë 15 m

3.654/1 Furnizim vendosje tuba plastmasi Ø 80 në sasinë 400 m

3.179 FV pusete plastike 40x40x40, kapak të forte RIC 1084 + 1086 në sasinë 20 copë

Për Mekanik 1 (një) punonjës,

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, kërkojnë një numër të konsiderueshëm për mjete dhe pajisjesh teknike (ku puna më e madhe do të kryhet nga këto mjete). Përcaktimi i kriterit për disponimin e 1 (një) mekaniku për mirëmbajtjen e tyre me qëllim që puna mos të pezullohet asnjëher, është i domosdoshme për të mbikqyrur makineritë dhe mekanizmat që nevojiten për kryerjen e këtyre punimeve.

Për teknik ndërtimi 1 (një) punonjës, Specialist Ndertimi 2 (dy) punonjës, për Karpentier 3 (tre) punonjës dhe Punëtor krahu 7 (shtatë) punonjës, Specialist për punime në rrugë 3 (tre) punonjës, të pajisur me dëshmi aftësie profesionale, nevojitet prezenca e tyre në kantier për “Rikualifikim i rrugëve Ligatë-Lumas-Dokollarë-Pëllumbas” duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime për sistemimin e shtresës së çakullit dhe stabilizantit në gjithë gjatësinë e rrugës përpara ngjeshjes së saj me makineri,

Duke përllogaritur orët e punës të nevojshme për kryerjen e vetëm 2 (dy) zërave të preventivit si më sipër cituar dhe konkretisht për punime shtresë çakulli mbeturina kave $t=10$ e përhapur e ngjeshur me makineri në sasinë 14198 m², dhe për shtresë stabilizanti në sasinë 14198 m², njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish për zbatimin e këtyre zërave duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

Në lidhje me argumentimin e mësipër njësia e prokurimit sqaron se për zbatimin me sukses të tyre, ka kërkuar 7 (shtatë) punonjës Punëtor krahu.

Në lidhje me ***Për teknik ndërtimi 1 (një) punonjës, Specialist Ndertimi 2 (dy) punonjës, si dhe karpentier 3 (tre) punonjës*** njësia e prokurimit sqaron se prezenta e tyre në kantier garanton AK për zbatimin e punimeve me sukses dhe me cilësi si punime ;

2.564 Themel butobetoni c20/25 në sasinë 37 m³

2.112 Mure buto betoni C 12/15 në sasinë 20 m³

3.244 Struktura monolite betoni C20/25 në sasinë 14m³

3.178 Ndërtim kasonete në tokë të butë në sasinë 450 m².

Referuar volumit të madhë të punimeve, NJP gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish për zbatimin e kontratës me sukses.

Në lidhje me Hekurkthyes 2 punonjës

Duke analizuar preventivin e punimeve, punonjësit e mësipërm përkon me punimet në zërat përkatës si :

2.166 F.V hekur betoni periodik Ø 6 – 10 mm në sasinë 1 ton

2.166/1a F.V hekur betony periodic Ø> 12 mm në sasinë 1 ton

Teknik Gjeodet/Topograf është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të sistemimit të jashtëm, sepse kemi punime të cilat kërkojnë precizion në kuota dhe nivele të caktuara ku duhen montuar strukturat apo elementet e ndryshëm dhe ata duhet të lexojnë projektin dhe kryejnë matjet e nevojshme.

Duke marrë në konsideratë faktin se investimi do të kryhet në terren të veshtirë, kodrinor, kërkesa e AK është në përputhje me objektin e kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponoje 1(një) punonjës i cili të jetë i pajisur me çertifikatë "Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "Për sigurinë në kantier",VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mësipërm.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si " *Koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 37 (tridhjetë e shtatë) persona, dhe të jenë në listëpagesën e shoqërisë në momentin e hapjes së tenderit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për tre muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 .

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit, për periudhën **si më sipër**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **si më sipër**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se

autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohet për realizimin me sukses të kontratës.

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj, si dhe kohëzgjatjes së parashikuar për realizimin e punimeve gjithësej 5 (pesë) muaj, njësia e prokurimit vlerëson se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohet për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmerinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Lidhur me përcaktimin e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka mbajtur në konsideratë Rekomandimin e APP Nr 4916/2 Prot të datë 14.07.2022, pika 3, ku përcaktohet se autoritetet kontraktore duhet të hartojnë kërkesat e veçanta të kualifikimit në përputhje me nenet 77 të LPP dhe 78 të VKM, si dhe legjislacionit të fushës përkatës, duke argumentuar domosdoshmërinë e tyre në çdo rast.

Bazuar mbi rekomandimin e APP, njësia e prokurimit ka hartuar analizën teknike ku parashikohet fuqia punëtore duke u bazuar në preventivin e punimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse ka përcaktuar numrin e saktë/ose minimal të punonjësve që nevojiten për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, duke përcaktuar secilin punonjës me kualifikim e duhur, gjithçka në funksion të objektin të kontratës.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 37 (tridhjetë e shtatë) punonjës të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

2.3.7 Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), *ose ekuivalent*
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*
- OHSAS 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme), *ose ekuivalent*.

- ISO 39001:2012 mbi “Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor” e vlefshme, *ose ekuivalente*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo çertifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohet edhe çertifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standardeve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qendrueshëm me avantazhe reciproke.

➤ **ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë çertifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas çertifikatës iso të mësipërme.

➤ **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit te ambjentit” e vlefshme, *ose ekuivalent*

Ky certifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky certifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor.

Kjo certifikatë është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njëësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuar nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të, duke kryer një proces riaftësimi më pas të ambjentit përreth ku do të kryhet investimi.

➤ **ISO 45001-2023** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) *ose ekuivalentet e tyre*

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem manaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë .

Kjo certifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve . Është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve të LPP.

Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve .

➤ **ISO 39001:2012** mbi “Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor” e vlefshme, *ose ekuivalente .*

Ky certifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor, që është një çështje delikate dhe aktuale, me anë të së cilës garantohen mundësitë e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor të një subjekti me synim parandalimin e aksidenteve dhe trafikun në rrugë, në respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me sinjalistikën rrugore. Gjithashtu, ky certifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve në menaxhimin e sigurisë të trafikut rrugor, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në këtë aspekt .

Standardi ndërkombëtar ISO 39001 është zhvilluar me qëllim për të ndihmuar në përmirësimin e sigurisë në trafikun rrugor. Ai cakton rregullat për një sistem menaxhimi i cili mund të implementohet nga çdo shoqëri e cila ndërton, projekton, administron apo përdor infrastrukturën rrugore.

ISO 39001 është zhvilluar me pjesëmarrjen e disa organizatave ndërkombëtare si Organizata Botërore e Shëndetësisë, Banka Botërore apo Federata Ndërkombëtare e Rrugëve.

Ky standard përfshin kërkesat që kanë të bëjnë me zhvillimin e një politike në lidhje me sigurinë në trafikun rrugor, ndërgjegjësimin e shoferëve, monitorimin e gjendjes teknike të automjeteve, përgatitjen për situata emergjente apo hetimin e aksidenteve në trafik.

Kjo certifikat është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor, për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë sepse kemi të bëjmë me një Rikualifikim i rrugëve të fshatit Lumas.

2.3.8 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtme :

Për përmbushjen e kesaj pikës, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8.

Nr	Makineri dhe pajisje	Nr	Njesia	Gjendja
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës jo më të vogël se 10 t	2	copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës jo më të vogël 20 t	2	copë	Në pronësi ose me qera
3	Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 t	2	copë	Në pronësi ose me qera
4	Kamion me vinç	1	copë	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator me Goma (mjet teknologjik me goma)	2	copë	Në pronësi ose me qera
6	Fadrome (mjet teknologjik me goma)	1	copë	Në pronësi ose me qera
7	Dumper (mjet teknologjik me goma)	1	copë	Në pronësi ose me qera
8	Grejder (mjet teknologjik me goma)	1	copë	Në pronësi ose me qera
9	Rul ngjeshes me vibrim	1	copë	Në pronësi ose me qera
10	Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m ³ (mjet teknologjik me goma)	2	copë	Në pronësi ose me qera

11	Autobot uji	1	copë	Në pronësi ose me qera
12	Autopompe Betoni	1	copë	Në pronësi ose me qera
13	RTV - Trasportier per mjete te renda	1	copë	Në pronësi ose me qera
14	Moto gjenerator	1	copë	Në pronësi ose me qera
15	Betoniere kantieri	2	copë	Në pronësi ose me qera
16	Vibrues betoni	2	copë	Në pronësi ose me qera
17	Këthyese hekuri / bango hekuri	1	copë	Në pronësi ose me qera
18	Total Station	1	copë	Në pronësi ose me qera
19	Kokore	37	copë	Në pronësi ose me qera
20	Jelek	37	copë	Në pronësi ose me qera
21	Tabela sinjalizuese kantieri	4	copë	Në pronësi ose me qera
22	Komplet i ndihmes se shpejte	2	copë	Në pronësi ose me qera
23	Armaturë/betoforma/lendë drusore min 200 m2	200	M2	Në pronësi ose me qera
24	Rrul Gome-Gome	1	copë	Në pronësi ose me qera
25	Autobitumatrice	1	copë	Në pronësi ose me qera
26	Asfaltoshtruese	1	copë	Në pronësi ose me qera
27	Impiant prodhim asfaltbetoni me QKL	1	copë	Nëpronësi, me qera, ose kontratë furnizimi
28	Nyje Inerte me QKL	1	copë	Në pronësi, me qera, ose kontratë furnizimi

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) si dhe taksa vjetore.
- b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga 25 administrator i shoqërisë ofertuese).
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të

verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve të ndërtimit dhe preventivit të hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kuçovë, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues të cilët duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë volume e punimeve, afatin për realizimin e saj, vlerën e kontratës, relacionin teknik është e nevojshme që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet e mësipërme për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit.

Analizë të detajuar në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor :

- Në lidhje me **kamion vetëshkarkues 2 copë me kapacitet minimumi 20 ton dhe 2 copë me kapacitet mbajtës min 10 ton dhe mjetin Dumper (mjet teknologjik me goma)**, njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen në volume të mëdha të cilat janë të domosdoshëm prania e mjeteve të mësipërme për transportimin e të gjitha materialeve të ndërtimit pranë kantierit dhe më konkretisht, për zërat :

3.207/1 shtresë çakëlli mbeturina kave t=10cm në sasinë 14198 m²,

3.212/b shtresë stabilizanti 10cm në sasinë 14198 m², disponueshmëria e mjeteve të sipërcitur garanton AK për zbatimin e kontratës me sukses.

Si dhe transport të lëndëve inerte, si më poshtë.

- Transport dheu me auto deri 5.0 km 410 m³

Në lidhje me mjetin dumper, njësia e prokurimit gjykon se ky mjet shërben për disa qëllimi, si për transportimin e materialeve në kantier, ashtu edhe për përhapjen e stabilizantit në basenin e rrugës përpara ngjeshjes dhe sistemimit të tij.

Duke analizuar proceset kryesore të punës sipas preventivit të punimeve dhe më sipër argumentuar, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal mjetesh në krahasim me volumet e punës që do të kryhet. Por duke qënë se këto procese pune mund të zgjaten edhe gjatë gjithë afatit të zbatimit të punime, kërkesa e mësipërme i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor dhe është në përputhje dhe vëllim të plotë me objektin e kontratës.

- Në lidhje me mjetin **Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton**, njësia e prokurimit sqaron se janë të nevojshëm për transportimin dhe sistemimin e materialeve të ndërtimit pranë kantierit në ato vende ku nuk mund të futen kamionat e mëdhenj me kapacitet mbajtës 20 dhe 10 ton. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceseve si transporti i materialeve, elektrike, tuba plastmasi, tuba betoni si dhe hekur betoni Ky mjet është i favorshëm pasi mund të qarkullojë në çdo orar.
- Në lidhje me mjetin **Kamion me vinc** Prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe konsiston në ngritjen e materialeve të rënda sipas kërkesave dhe nevojave të projektit, dhe konkretisht për ngritjen e tuba betoni dhe tuba plastmasi dhe vendosjen e tyre në vendet përkatës. Si dhe ngritjen e krah shtylla metalike dhe vendosjen e tyre në vepër.
- Në lidhje me mjetet **Fadrome (mjet teknologjik me goma) 1 copë, Eskavator me Goma (mjet teknologjik me goma) 2 copë**, njësia e prokurimit sqaron se mjetet e mësipërme garantojnë zbatimin e punimeve si hapjen e rrugëve, gërmimet që do të kryhen pranë kantierit të ndërtimit në sasinë 410 m³ si dhe sistemimet pranë kantierit të ndërtimit. Nisur nga volumet e punës, terrenit ku do të kryhen investimi i cili është kodrinor, dhe afatit të zbatimit të punimeve si dhe duke marrë në konsideratë se zbatimi i punimeve të gërmimit do të kryhen në muajin e parë, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një

numër mjetesh për gjermim në përputhje me objektin e kontratës duke garantuar AK për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

- Në lidhje me mjetet, **Rrul ngjeshës me vibrim 1 copë, rrul gomë gomë 1 copë dhe Grejder 1 copë,**

Njësia e prokurimit sqaron se mjeti Grejder është i domosdoshme për nivelimin e çakëllin në sasinë 14198 m², kurse mjeti Rrul ngjeshës me vibrim është i nevojshëm për ngjeshjen e stabilizantit dhe granilit në sasinë 14198 m². Si dhe rrul gomë gomë është i nevojshëm për ngjeshjen e asfaltobetonit.

Disponimi i mjeteve të mësipërm nga ana e ofertuesve garanton autoritetin kontraktor që zbatimi i punimeve të kryhet në kohë dhe në përputhje me grafikun e punimeve si dhe preventivin e punimeve.

- Në lidhje me **Asfaltoshtruese 1 copë, dhe Autobitumatrice 1 copë,** njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen të cilat janë të domosdoshëm prania e mjeteve të mësipërme për zërat e preventivit dhe më konkretisht :

Për zërin 3.233/4 Shtresë asfaltobetonit me zall lavatriçe, 7 cm me makineri.

Autobitumatrice është e nevojshme për hedhjen e prajmerit (që hap lëngun para shtrimit të asfaltit).

Asfaltoshtruesja është e nevojshme për shtrimin e asfaltit në sasinë 12620 m².

Disponimi i mjeteve të mësipërm nga ana e ofertuesve garanton autoritetin kontraktor që zbatimi i punimeve të kryhet në kohë dhe në përputhje me grafikun dhe preventivin e punimeve.

- Në lidhje me mjetin **RTV - Transportier për mjete të rënda**

Mjeti i mësipërm është i nevojshëm për transportimin pranë kantierit të ndërtimit të mjeteve Rrul ngjeshës me vibrim 1 copë, rrul gomë gomë 1 copë, për shkak se mjetet e mësipërme konsiderohen mjete kantieri dhe nuk mund të qarkullojnë në rrugë normalisht.

- Në lidhje me mjetet **Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m3 (mjet teknologjik me goma) 2 copë, Betoniere kantieri 2 copë, Vibrues betoni 2 copë, Armaturë/betoforma/lendë drusore min 200 m2,** njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen të cilat janë të domosdoshëm prania e mjeteve të mësipërme si dhe të betoformës për zërat e preventivit dhe më konkretisht :

2.564 Themel butobetoni C 20/25 në sasinë 37 m³
2.112 Mure buto betoni C 12/15 në sasinë 20 m³
3.244 Struktura monolite betoni C20/25 në sasinë 14 m³
3.178 Ndërtim kasonete në tokë të butë në sasinë 450 m².

➤ **Moto gjenerator (1 copë)** ; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht në momente kur nuk kemi energji elektrike.

➤ **Autobot uji (1 copë)**; janë të nevojshme në rastin kur ka mungesë të furnizimit me ujë, kur duhet bërë llaçi për strukturat monolite betoni, ujitja e rrugës etj.

➤ **Këthyesë hekuri / bango hekuri**

Nisur nga objekti i kontratës dhe bazuar në preventivin e punimeve, NJP gjykon se pajisja e mësipërme i shërben zbatimin të kontratës me sukses për punimeve si

2.166 F.V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm².

2.166/1a F.V hekur betoni periodik Ø > 12 mm².

➤ **Total Station** kërkohet pasi kemi matje topografike përsa i përket rievimeve dhe sistemimeve të jashtme.

➤ **Kokore 37 copë, dhe Jelek 37 copë**

Në lidhje me pajisjet teknike më sipër, NJP sqaron se janë kërkuar në përputhje me numrin e punonjësve të kërkuar nga AK në dst, si dhe në zbatim të plotë të kodit të punës dhe sigurisë së punonjësve në kantier.

Lidhur me kërkesën për Fabrikë asfaltbetoni dhe Impiant inertesh me leje mjedisore ku ofertuesit duhet ti disponojnë në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi, njësia e prokurimit argumenton se :

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Bazuar dhe në preventivin e punimeve, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të 1 (një) impiant për prodhimin e asfaltobetonit dhe 1 (një) impiant inertesh, në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, përsa kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST, duke e lënë të hapur përmbushjen e këtij kriteri në respekt të plotë të ligjit të prokurimit publik, duke rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore duke nxitur njëkohësisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik .

Në preventin e punimeve, autoriteti kontraktor ka parashikuar punime :

si 3.233/4 Shtresë asfaltobetonit me zall lavatriçe 7 cm me makineri në sasinë 12620 m², si dhe 3.207/1 Shtrese çakëlli mbeturine kave t=10cm, përhapur e ngjeshur makineri në sasinë 14198, dhe

3.212/b Shtresë stabilizanti 10cm në sasinë 14198 m².

Duke pare volume e mëdha të punës që do të kryhen, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të kërkojë garanci nga ofertuesit për përbushjen me sukses të çdo zëri të preventivit të punimeve.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

➤ Në lidhje me impiantin e fabrikës së asfaltobetonit dhe nyje inertesh me lejen mjedisore të lëshuar nga QKL me kodin III.1.B, njësia e prokurimit argumenton se

:

Në fushën III, Kategoria III.1. të VKM nr.538 datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Ndërkombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", parashikohet se :

" Lejet mjedisore të përcaktuara në 34 pika 5 e ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar bëjnë pjesë në kategorinë III.1 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"

2. Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon :

a) "Leje e thjeshte mjedisore" me kodin III.1.A;

b) "leje mjedisore" me kodin III.1.B;

c) "leje e integruar mjedisore" me kodin III.1.C.

3. Emërtimi në pikën 2.a zëvendëson emertime "autorizim mjedisor" dhe "pëlqim mjedisor" që përdoren para fillimit të zbatimit të këtij vendimi sipas pikës 7 më poshtë. 4. Leja e nënkategorive A, B, C, trajtohen sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese që dorëzohen nga kërkuuesi, kuptimi i llojit të veprimtarive dhe i ndikimit të tyre në mjedis, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkesë prej tij dhe afatet për t'iu përgjigjur QKL-së për një kërkesë që ka kaluar fazën e parë nga QKL, për nënkategoritë A, B, C janë ato respektivet e përcaktuara nga ligji nr.8934, datë 5.9.2002 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar, dhe aktet nën/ligjore në zbatim të tij".

Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara njësia e prokurimit argumenton se në lidhjen 1/B të VKM nr.538 datë 26.05.2009 përcaktohet shprehimisht se kategoria e liçensës III-1B lëshohet për kryerjen e aktiviteteve të tilla si "Nxjerra e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret" dhe "Përzierje e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullim i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të

çimentos. Në këtë kuptim njësia e prokurimit gjykon se kjo kategori license nga dokumentat e procedurës është e bazuar në kushtet kur ligji parashikon shprehimisht se për kategorinë e veprimtarive të sipërcituara shoqëritë e kanë të detyrueshmë pajisjen me këtë licensë. Referuar parashikimeve ligjore të aktit normativ në zbatim të ligjit VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Ndërkombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përmbashkëta”, paisja e një instalimi me leje mjedisore e kërkuar nga autoriteti kontraktor është në propocion me objektin e prokurimit jo diskriminues dhe në përputhje me përmasat e kontratës.

2.3.9 Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve te ngurta, inerte”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve te ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjisllacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë”) se bashku me aktin e miratimit .

Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve si dhe Transport dheu me auto deri 5.0 km në sasinë 410 m2, dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përmbashkëta”.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “ Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ”, parashikohet se “ Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër, konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivti, kërkesa e autoritetit kontraktor për licencim është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, pasi krahas punimeve të gërmimit, operatori ekonomik fitues i kontratës duhet të

kryejë edhe transportin e mbetjeve urbane, transportin e dherave dhe inerteve, i cili referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara .

Kërkesa e mësipërme për Kodi III.2.B, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 dhe 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

2.3.10 Operatori ekonomik në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës të publikuar ne DST, për materialet si më poshtë:

- a) Beton
- b) Inerte
- c) Hekur
- d) Shtylla Elektrike
- e) Asfalt

Duhet të paraqesë:

1. Autorizim te Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument të paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese autorizimin e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentim : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 44, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit

kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njëësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe materialet e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, çertifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kerkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si : çertifikatë/deklaratë konfirmimit, çertifikatat e cilësisë ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kerkuara ne Specifikimet teknike.

Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskriminon midis operatorëve ekonomikë ofertues vendas dhe të huaj, pasi standartet e kerkuara është Standardi Shqiptar i cili është i harmonizuar me Standardin European.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet dhe furnizimet që parashikohen të realizohen në preventiv, duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve bashkëkohore. Prandaj e gjykojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve europiane, në mënyrë që të provohet që operatori ekonomik ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kerkuara në dokumentat e tenderit.

Me anë të vënies në dispozicion në fazën e ofertimit të dokumentave si autorizim-marrëveshje angazhimi, skeda teknike, çertifikata cilësie, çertifikata konformiteti dhe raporte testimi, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë në përputhje sipas kërkesave të projektit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,**duke***

argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT